

STATUTI i Bashkisë së Strigarit

Neni 1

Parime themelore

1. Bashkia e Strigarit është një ent autonom vendor që ka përfaqësueshmëri të përgjithshme sipas parimeve të Kushtetutës e të ligjit të përgjithshëm të Shtetit.
2. Vetëqeveria e Bashkësisë zbatohet me pushtetet e institutet për të cilat është fjala në këtë Statut që cakton rregullat themelore të organizimit të entit.

Neni 2

Qëllime

1. Bashkia nxit zhvillimin e përparimin civil, shoqëror e ekonomik të Bashkësisë së vet duke u frymëzuar nga vlerat dhe objektivet e Kushtetutës.
2. Bashkia ndjek bashkëpunimin e kooperimin me të gjitha personat publikë dhe privatë dhe nxit pjesëmarrjen e qytetarëve, të forcave shoqërore, ekonomike dhe sindikale në administrimin.
3. Sfera e qeverisjes së Bashkisë përbëhet nga caqet territoriale të interesave.
4. Bashkia vepron duke u frymëzuar nga kriteret e parimet pasuese:
 - a) kapërcimi i çekuilibri meve ekonomike, shoqërore, territoriale që gjenden në rrethin e vet e në Bashkësinë kombëtare;
 - b) nxitja e funksionit shoqëror të nismës ekonomike, publike e private edhe nëpërmjet zhvillimit të formave shoqërie ekonomike dhe kooperimi;
 - c) mbështetja për realizimin e një sistemi të përgjithshëm dhe të integruar sigurie shoqërore e mbrojtjeje aktive të personit edhe me veprimin e organizatave pune vullnetare;
 - ç) mbrojtja e zhvillimi të pasurive natyrore, mjedisore, historike e kulturore të pranishme në territorin e vet për t'i garantuar bashkësisë një cilësi më të mirë të jetës;
 - d) ruajtjen e traditave e të veçorive gjuhësore, folklorike e kulturore arbëreshe nëpërmjet krijimit të strukturave të afta për mbrojtjen e trashëgimisë, nxitjes dhe mbështetjes të çdo veprimi që mbahet si i vlefshëm në këtë drejtim;
 - dh) nxitja e parimeve për të garantuar kushte mundësish të barabarta midis burrit dhe gruas.

5. Për arritjen e qëllimeve të përmendura në pikën e mëparshme, Bashkia mund bëhet anëtare organizmash dhe shoqatash ndër- e mbibashkiake.

Neni 3

Programim dhe forma kooperimi

Bashkia zbaton qëllimet e veta duke pranuar metodën e mjetet e programimit.

Bashkia bashkëpunon në caktimin e objektivave të përmbajtura në programet e Shtetit dhe të krahinës Kalabri, duke shfrytëzuar ndihmesën e formacioneve shoqërore, ekonomike, sindikale e kulturore që veprojnë në territorin.

Marrëdhëniet me Bashkitë e tjera, me Provincën e Krahinën ndjekin parimet e kooperimit, barasrenditjes, plotësimit e ndihmësisë midis sferave të ndryshme të autonomisë.

Për të arritur një cilësi më të mirë të shërbimeve, Bashkia mund t'i lëshojë funksione të veta Bashkësisë Malore.

Neni 4

Tipare

1. Territori i Bashkisë shtrihet për 14,07 kmk, duke u kufizuar me Bashkitë e Vakaricit, Mbuzatit, Akrës, Shën Mitrit Koronë e Corigliano Calabros. Në të gjendet kryeqendra që përmban tërësinë e popullsisë me prani të vetmuara banimi në fushat Matermare, Campanaro, Saline, Vallepalmu, Marlule e Vallone Grande.
2. Pallati bashkiak, seli e Bashkisë, gjendet në Sheshin e Lirisë, 1, të kryeqendrës.
3. Mbledhjet e organëve kolegiale të zgjedhur zhvillohen në selinë bashkiake. Në raste krejtësisht të jashtëzakonshme e për nevoja të veçanta mund të mbledhet edhe në vende të tjera.
4. Ndryshimi e emërimit të qendrës dhe të selisë bashkiake mund të vendoset vetëm nga Këshilli, pas një referendumi.

Neni 5

Tabela e lajmërimeve

1. Këshilli Bashkiak cakton në pallatin e Bashkisë një vend të posaçëm për t'u shfrytëzuar si tabelë lajmërimesh për botimin e akteve dhe lajmërimeve të parashikuara nga Ligji, nga Statuti e nga Rregulloret.

2. Botimi duhet të garantojë hyrjen, tërësinë dhe një lexim të lehtë e të plotë.
3. Sekretari Bashkiak kujdeset për afishimin e akteve për të cilat është fjala në paragrafin 1 duke përdorur një lajmërues bashkiak dhe pas dëshimit të tij vërteton botimin e kryer.

Neni 6

Stema e flamuri

1. Bashkia në aktet e në vulën njëjtësohet me emërtimin "Bashkia e Strigarit" e me stemën e dhënë me dekret të Presidentit.
2. Në ceremonitë dhe në festat e tjera publike, me praninë e Kryebashkiakut o të një zëvendësi të autorizuar, mund të paraqitet flamuri bashkiak në mënyrën e caktuar me D.P.C.M. të 3.11.1987.
3. Ndalohen përdorimi dhe riprodhimi simbolesh të tilla për qëllime jointucionale.
4. Kompetenca mbi tiparet e stemës dhe të flamurit i përket vetëm Këshillit Bashkiak, ndërsa Kryebashkiaku, pasi dëgjoji Juntën Bashkiake, ka përgjegjësinë të vendosë për përdorimin e riprodhimin e simboleve për të cilat është fjala në paragrafët 1 e 2 , në caqet e paragrafit 3 të këtij neni.

PJESA I

RENDI NDËRTIMOR

TITULLI I

Organët e zgjedhur

Neni 7

Janë organë të zgjedhur të Bashkisë Këshilli, Junta e Kryebashkiaku.

Neni 8

Këshilli Bashkiak

1. Këshilli Bashkiak, duke përfaqësuar bashkësinë e tërë, cakton drejtimin e ushtron mbikëqyrjen politiko-administrative.
2. Këshilli, i përbërë sipas Ligjit, gëzon autonomi organizuese funksionale.

Neni 9

Kompetenca e detyra

1. Këshilli Bashkiak ushtron pushtetin e kompetencat të parashikuara prej Ligjit, kryen detyrat e veta duke u frymëzuar nga parimet, kriteret, mënyrat e procedurat e caktuara në këtë Statut dhe në Rregulloret.
2. Zhvillon veprimin e përgjithshëm të entit duke ndjekur parimet e publicitetit, tejdukshmërisë dhe ligjshmërisë për të garantuar mbarëvajtjen dhe paanësinë.
3. Në vendosjen e akteve themelore privilegjon metodën e mjetet e programinit, duke pasur si qëllim bashkërenditjen me programimin provincial e shtetëror.
4. Aktet themelore duhet të përmbajnë caktimin e objektivave e të qëllimeve që duhen arritur, burimet e financimeve dhe përdorimin e tyre dhe të mjeteve të nevojshme për veprimet që duhen zhvilluar.

Neni 10

Sesione e thirrje

1. Veprimi i Këshillit zhvillohet në sesione të zakonshme dhe të jashtëzakonshme.
2. Sesione të zakonshme janë ato që thirren për miratimin e akteve themelore të parashikuara nga neni 32, par. 2, shkronja b, e ligjit 142/90.
3. Këshilli thirret nga Kryebashkiaku që harton rendin e ditës e kryeson punimet, sipas nenet e Rregullores.
4. Detyrat të parashikuara nga paragrafi 3, në rast dorëheqjeje, rënie, dëbimi ose vdekjeje të Kryebashkiakut i kryen Këshilltari më i moshuar vetëm për sesionet të jashtëzakonshme për zgjedhjen e organëve të rinj administrues.

Neni 11

Komisione

1. Këshilli Bashkiak mund të krijojë brenda vetes komisione të përhershme, të përkohshme apo të veçanta posh komisioneve të detyrueshme institucionale të parashikuara nga Ligji.
2. Rregullorja disiplinon numrin e tyre, lëndët e kompetencës, funksionimin e përbërjen e tyre sipas kriterit përpjesëtimor, me zgjedhjen e përfaqësuesve të pakicës me votë të kufizuar. Mund të parashikohet një sistem përfaqësimi të shumëfishtë apo nëpërmjet delegimi.

3. Komisionet mund të ftojnë që të marrin pjesë në punimet e veta Kryebashkiakun, asesorë, organizma të shoqëruara, funksionarë e përfaqësues të forcave shoqërore, politike e ekonomike për shqyrtimin e subjekteve të veçanta.
4. Komisionet duhet të dëgjojnë Kryebashkiakun e asesorët çdo herë këta e lypin.

Neni 12

Detyra të komisioneve

1. Detyra kryesore e komisioneve të përhershme është shqyrtimi parapraku i akteve vendimore të Këshillit, për të nxitur ushtrimin më të mirë të funksioneve të organit vetë.
2. Detyra e komisioneve të përkohshme e të veçanta është shqyrtimi i lëndëve të lidhura me çështje me karakter të veçantë apo të përgjithshëm të pikasura nga Këshilli Bashkiak në caqet e lëndës tek ka kompetencë.
3. Rregullorja disiplinon ushtrimin e detyrave pasuese:
 - emërimin e Kryetarit të Komisionit;
 - thellimin e propozimeve për vendime, që organët e Bashkisë i kanë falur;
 - pikasjen e formave për shprehjen e mendimeve mbi nismat për të cilat, falë vendimi të organit kompetent apo sipas parashikimit të rregullores, mbahet si i përshtatshëm keshillimi paraprak;
 - rregullorizimi i metodave, procedurave e afateve për zhvillimin e studimeve, hulumtimeve, kërkimeve e përpunimeve propozimesh.

Neni 13

Këshilltarët

1. Gjendja juridike dhe statusi të këshilltarëve rregullohen nga Ligji. Këta përfaqësojnë bashkesinë e tërë, ndaj së cilës duhet të përgjigjen.
2. Funksionet e këshilltarit të moshuar ushtrohen nga këshilltari që ka marrë numrin më të madh të votave individuale.
3. Dorëheqja nga detyra e Këshilltarit i drejtohet Kryebashkiakut, i cili është i detyruar ta përfshijë në rendit e ditës të së parës seancë të Këshillit që duhet mbajtur brenda 30 ditësh.
4. Dorëheqja ka efekt qysh nga paraqitja e saj e bëhet e patërheqshme pasi Këshilli Bashkiak mori shënim për atë.

5. Vendi që gjatë katërvjetëshit mbetet i zbrazët për një shkak të çdollojtë, edhe nëse të mbiardhur, i jepet kandidatit që në listën e njëjtë vjen fill pas të zgjedhurin e fundit. Nëse një Këshilltar është pezulluar, zëvendësimi i tij i përkohshëm rregullohet nga Ligji.

Neni 14

Të drejta e detyra të Këshilltarëve

1. Mënyrat e ushtrimit të së drejtës së nismës dhe të mbikëqyrjes, të parashikuara nga Ligji, disiplinohen nga Rregullorja.
2. Shqyrtimi i propozimeve vendimi dhe të amendamenteve që i ndryshojnë në mënyrë qenësore i nënshtrohet marrjes së mendimeve të parashikuara nga Ligji, sipas parimit të vendimit të drejtë, në fuqi të të cilit marrja e vendimit i nënshtrohet hetimit paraprak të pajisur me mendime teknike, llogarie dhe ligjshmërie e lajmërimit të mëpasshëm Juntës e përgjegjësve të grupeve të Këshilltarëve.
3. Çdo Këshilltar është i detyruar të zgjedhë një banim në territorin bashkiak dhe të tregojë një person i cili, në rast mungese, është i autorizuar të marrë të gjitha aktet e thirrjes apo lajmërimet të parashikuara nga rregullat e Ligjit ose sipas Rregullores.
4. Për sa më të madhen tejdukshmëri, çdo Këshilltar duhet të lajmërojë, sipas mënyrave të caktuara nga Rregullorja, në fillim dhe në fund të mandatit, gjendjen e së ardhurës dhe të pronës. Ky detyrim vlen edhe për asesorët e jashtëm të parashikuar nga neni i mëpasshëm 18 në paragrafin 2.
5. Kryebashkiakut, asesorëve e këshilltarëve u ndalohe të marrin detyra e këshillime në ente e institucione që varen nga Bashkia e vet apo i nënshtrohen mbikëqyrjes dhe kontrollit të saj.
6. Këshilltarët mund të paraqitin pyetje dhe çdo kërkesë tjetër sindikati inspektimi Kryebashkiakut apo asesorëve të autorizuar, sipas mënyrave të Rregullores së Këshillit.

Neni 15

Grupe Këshilltarësh

1. Këshilltarët mund të bashkohen në grupe, sipas Rregullores, duke njoftuar Sekretarin Bashkiak, që njofton Këshillin në seancën drejtpërdrejt të mëpasshme. Nëse nuk shfrytëzohet kjo mundësi, mbahen si përgjegjes e grupeve Këshilltarët, jashtë Juntës, që morën për çdo listë numrin më të madh e votave.
2. Rregullorja mund të parashikojë konferencën e përgjegjësve të grupeve dhe detyrat përkatëse.

Neni 16
Junta Bashkiake

1. Junta është organi i qeverisjes së Bashkisë.
2. Në veprimin e vet ajo frymëzohet nga parimet e kolegjalitetit, tejdukshmërisë dhe efektivitetit.
3. Vendos kolegjalisht të gjitha aktet konkrete, të afta për arritjen e objektivave dhe qëllimeve të Entit në caqet e drejtimeve të përgjithshme dhe në zbatim të akteve themelore të miratuara nga Këshilli Bashkiak.
4. Shqyrton kolegjalisht subjektet që i duhen nënshtruar Këshillit Bashkiak.

Neni 17
Zgjedhje e të drejta të veçanta

1. Junta zgjidhet në afatet e në mënyrat të caktuara prej Ligjit, sipas dokumentit programatik të dorëzuar Sekretarit Bashkiak së paku 5 ditë para mbledhjes së Këshillit. Për zëvendësimin e një apo dy asesorëve, zgjedhja bëhet me vota të fshehta.
2. Arsyet pazgjidhshmërie dhe papajtueshmërie, gjendja juridike, statusi i pjesëmarrëve dhe institutet e rënies dhe të shfuqizueshmërisë disiplinohen nga Ligji.
3. Përveç rasteve papajtueshmërie të parashikuara në paragrafin 2, nuk mund bëjnë njëkohësisht pjesë të Juntës paraardhësit dhe pasardhësit, birësuesi dhe i birësuari, vëllezër, bashkëshortë dhe të afërm të shkallës së parë.
4. Kryebashkiaku dhe Asesorët, përveç rasteve të dorëheqjes së Asesorëve të veçantë, mbeten në fuqi deri në marrjen e detyrës të pasardhësve.

Neni 18
Përbërja

1. Junta përbëhet nga Kryebashkiaku e nga dy Asesorë.
2. Një Asesor mund të emërohet midis qytetarëve jo Këshilltarë, me prestigj, profesionalitet dhe kompetencë administrative.
3. Asesorët e jashtëm marrin pjesë në Këshillin, pa të drejtë votimi, për të sqaruar subjektet që i përkasin detyrës së tyre.
4. Nuk mund të bëjnë pjesë të Juntës bashkëshortja, paraardhësit, pasardhësit, farefisët, të afërmit e Kryebashkiakut deri në shkallën e tretë.

Këta nuk mund të emërohen përfaqësues të Bashkisë as mund marrin këtë detyrë për më se dy mandate të njëpasnjëshme.

Neni 19

Funksionimi i Juntës

1. Junta thirret e kryesohet nga Kryebashkiaku, i cili cakton rendin e ditës, duke mbajtur para sysh subjektet të propozuara nga Asesorët të veçantë.
2. Mënyrat e thirrjes dhe e funksionimit vendosen nga Junta vetë, e cila i formalizon në akt vendimor në seancën e parë pas zgjedhjes.

Neni 20

Kompetencat

1. Junta bashkëpunon me Kryebashkiakun në administrimin e Bashkisë dhe vepron nëpërmjet vendimeve kolegjale. Bën aktet e administrimit që sipas Ligjit nuk i përkasin Këshillit dhe që sipas Ligjit apo Statutit nuk hyjnë në kompetencën e Kryebashkiakut, të organëve të decentralizimit, të sekretarit apo të funksionarëve; bashkëpunon me Kryebashkiakun në zbatimin e drejtimeve të përgjithshme të Këshillit; i raporton Këshillit çdo vit mbi veprimin e vet dhe vepron me këtë nëpërmjet propozimeve dhe shtysave.
2. Junta zhvillon funksionet në kompetencën e vet me vendime të përgjithshme, në të cilat tregohen objektivet e qëllimet të ndjekura, mjetet e afta e kriteret, të cilavet duhet t'u përmbahen zyrat e tjera në ushtrimin e kompetencave gjestionale dhe ekzekutive që Ligji e Shteti u japin.
3. Junta, veçanërisht, në ushtrimin e detyrave qeverisjeje
 - a) i propozon Këshillit Rregulloret;
 - b) miraton projekte, programe ekzekutive, shastime zbatimore të programeve dhe thë gjitha vendimet që bashkëbartin zotime shpenzimesh mbi caktimet e buxhetit, që nuk i përkasin Kryebashkiakut apo Sekretarit;
 - c) përpunon vija drejtimi e përgatit shastime e propozime vendimesh që i duhen nënshtruar vullnetit të Këshillit;
 - ç) ndërmer veprime nisme, shtyse dhe harmonizimi me organët e pjesëmarrjes;
 - d) përpunon dhe i propozon Këshillit kriteret për caktimin e tarifave;
 - dh) emëron komisione për përzgjedhjet publike e të rezervuara;
 - e) merr vendime për marrjen në punë, reshtjen, e pezullimin nga funksionet të nëpunësve bashkiakë;
 - ë) propozon kriteret të përgjithshme për dhënien e subvencioneve, kuotave, ndihmave dhe leverdive ekonomike të çdollojta Enteve dhe personave;
 - f) vendos miratimin apo mosmiratimin e trashëgimeve dhe dhurimeve;

- g) autorizon Kryebashkiakun të dalë në gjyq si paditës apo i paditur dhe miraton ujdin;
- gj) cakton datën e thirrjes për referendimet këshillore e përbën zyrën bashkiake për zgjedhjet, e cila ka detyrën të vërtetojë rregullsinë e procedurës;
- h) ushtron, pasi u caktuan kostot e u pikasën mjetet, funksione të autorizuar nga Provinca, Krahina apo Shteti, kur Ligji apo Statuti nuk ia jep ndonjë organi tjetër;
- i) miraton ujdin kontratimi të decentralizuar, përveç lëndës të rezervuar kompetencës normative të Këshillit;
- j) i raporton çdo vit Këshillit mbi veprimet e veta dhe mbi zbatimin e programit;
- k) cakton sipas rregullores dhe ujdive të decentralizuara parametrat, standardet dhe detyrat funksionale e pune për të masur prodhueshmërinë e nëpunësve, pasi u këshillua me Sekretarin Bashkiak.

Neni 21

Vendime të organëve kolegjalë

1. Organët kolegjalë vendosin vlefshëm me ndërhyrjen e gjysmës së të përbërësve të caktuar dhe me shumicë votash pro mbi kontratat, përveç rasteve me shumicë të veçantë të parashikuara shprehimisht nga Ligjet e Shtetit.
2. Vendimet merren me votim të dukshëm, përveç rasteve vendimi mbi çmimin e cilësive subjektive apo vlerësimin e veprimit të personave, sidomos për detyra profesionale, për të cilat parashikohet votimi i fshehtë.
3. Seancat e Këshillit dhe të Komisioneve të Këshillit janë publike. Nëse duhet të shprehen vlerësime dhe çmime mbi persona Kryetari vendos të trajtohet subjekti në seancë private.
4. Për hetimin e dokumentimin e propozimeve vendimi, regjistrimin e akteve e verbalizimin e seancave të Këshillit e të Juntës kujdeset Sekretari Bashkiak, sipas mënyrave dhe afateve të caktuara nga Rregullorja. Sekretari Bashkiak nuk merr pjesë në seancat kur gjendet në një nga rastet e papajtueshmërisë. Atëherë në mënyrë të përkohshme e zëvendëson një përbërës i Kolegjit i emëruar nga Kryetari.
5. Procesverbalet e seancave i nënshkruajnë Kryetari, Sekretari e përbërësi më i moshuar ndër të pranishmit.

Neni 22

Kryebashkiaku

1. Kryebashkiaku është kreu i Administratës dhe si i tillë ushtron funksione përfaqësimi, presidencia, mbikëqyrjeje e administrimi.
2. Ka kompetencë e pushtet drejtimi, kontrolli e mbikëqyrjeje mbi veprimin e Asesorëve dhe mbi strukturat gjestionalo-ekzekutive.
3. Ligji disiplinon mënyrën e zgjedhjes, rastet e papajtueshmërisë dhe të pazgjidhshmërisë në zyrën e Kryebashkiakut, statusin e tij dhe arsyet për reshtjen nga detyra.
4. Përveç kompetencave të caktuara nga Ligji, ky Statut e Rregulloret i japin Kryebashkiakut detyra si organ i administrimit, i mbikëqyrjes dhe pushtet vetorganizimi për kompetencat që i përkasin detyrës së tij.

Neni 23

Detyra administrimi

1. Kryebashkiaku

- a) ka përfaqësimin e përgjithshëm të Entit;
- b) ka drejtimin unitar e bashkërenditjen e veprimit politko-administrativ të Bashkisë;
- c) bashkërendit veprimin e secilit Asesor;
- ç) mund të vendosë marrjen e akteve të veçanta të lidhura me veprimin administrativ të secilit Asesor për t'i nënshtruar shqyrtimit të Juntës;
- d) i jep udhëzime Sekretarit Bashkiak për drejtimet funksionale dhe mbikëqyrjeje mbi të tërë gjestionin administrativ të të gjitha zyrave e shërbimeve;
- dh) ka pushtet autorizimi;
- e) nxit e merr nisma për të përfunduar ujdj programi me të gjithë personat publikë të parashikuar nga Ligji;
- ë) mund të përmbarojë ujdj me personat e interesuar për të caktuar përmbajtjen vetëgjykimore të vendimit përfundor;
- f) thirr referendumet këshillimore;
- g) shpall urdhëresa të zakonshme;
- gj) lëshon autorizimet tregtare e policie administrative dhe autorizimet e lejet e ndërtimit;
- h) merr vendime për zënien e ngutshmë në punë e shpronësime që Ligji i jep në përgjithësi kompetencës së Bashkisë;
- i) pasi u këshillua me Juntën jep banimet publike;
- j) miraton rolet e taksave, të kanonëve e të ardhurave bashkiake;
- k) merr vendime sa për personelin, që Ligji e Rregullorja nuk u japin Juntës apo Sekretarit Bashkiak;
- l) cakton orarët e hapjes për qytetarët të zyrave, të shërbimeve e të ushtrimeve bashkiake, pasi u këshillua me Juntën e me organizatat sindikale;
- ll) i çon zyrës së Sekretarit Bashkiak aktin e dorëheqjes me qvllim që Këshilli të marrë shënim të rëniës së Juntës;

- m) si përfaqësues i Entit lidh kontratat;
- n) emëron e heq nga detyra Asesorët, duke i dhënë Këshillit një njoftim me arsyt;
- nj) brenda afateve të Ligjit emëron, cakton e heq përfaqësuesit e Bashkisë pranë Enteve, firmave e institucioneve sipas drejtimeve të caktuara nga Këshilli;
- o) ushtron të gjitha funksionet e tjera të parashikuara nga Ligji.

Neni 24

Detyra mbikëqyrjeje

1. Kryebashkiaku

- a) merr drejtpërdrejt nga të gjitha zyrat e shërbimet njoftime e akte edhe të rezervuara.
- b) nxit drejtpërdrejt, me ndihmën e Sekretarit Bashkiak, hetime e kontrole mbi të tërën veprimtari të Bashkisë.
- c) përmbush aktet ruajtjeje të të drejtave të Bashkisë.
- ç) bashkëpunon me Revizorin e Llogarive të Bashkisë për të përcaktuar mënyrat e zhvillimit të funksioneve të tij ndaj institucioneve.
- d) nxit e merr nisma për të vënë zyrat, shërbimet e institucionet që i përkasin Bashkisë në gjendje të zhvillojnë veprimtaritë e tyre sipas objektivave të caktuara nga Këshilli dhe në përputhje me drejtimet zbatimore të shprehura nga Junta.

Neni 25

Të drejta organizimi

Kryebashkiaku:

- a) vendos subjektet në rendin e ditës të seancave, cakton thirrjen e Këshillit Bashkiak dhe e kryeson sipas Rregullores. Kur e kërkon 1/5 e Këshilltarëve, bën thirrjen.
- b) thërret e kryeson konferencën e kryegrupeve të Këshillit sipas disiplinës së Rregullores.
- c) ushtron pushtetin e policisë në mbledhjet e Këshillit e në organizmat publikë pjesëmarrjeje popullore që kryeson vetë në caqet e parashikuara nga Ligji.
- ç) propozon subjektet që duhen trajtuar, vendos thirrjen e Juntës dhe e kryeson.
- d) ka pushtetin e lëshimit të pjesshëm të kompetencave dhe të të drejtave të veta një o më Asesorëve o Këshilltarëve bashkiakë dhe të lëshimit të përgjithshëm, kur nuk parashikohet figura e Zëvendës Kryebashkiakut, për të cilin është fjala në nenin e pastajshëm 26.
- dh) lëshon nënshkrimin e akteve të veçanta që nuk hyjnë në të drejtat e lëshuara Asesorëve apo Sekretarit Bashkiak.

e) merr pyetjet e mocionet që i duhen nënshtruar Këshillit.

Neni 26

Zëvendës Kryebashkiaku

1. Zëvendës Kryebashkiaku është asensori që merr nga Kryebashkiaku lëshimin e përgjithshëm për ushtrimin e funksioneve të tij në rast dorëheqjeje, pengese të përhershme, dëbimi, rënieje apo vdekjeje për periudhën e parashikuar nga Ligji. Në të parën seancë pas zgjedhjeve Kryebashkiaku njofton Këshillin për këtë emërim si edhe për përbërjen e Juntës dhe për propozimin e drejtimeve të përgjithshme të qeverisjes.
2. Asesorët, nëse Zëvendës Kryebashkiaku nuk u emërua ose nuk është i pranishëm ose ka ndonjë pengesë, ushtrojnë funksionet e zëvendësimit të Kryebashkiakut sipas rendit e moshës, me kusht që në dokumentin programatik nuk u vendos një rend i ndryshëm në rast zëvendësimit.
3. Për lëshimet që i bëhen Zëvendës Kryebashkiakut duhet t'i jepet njoftim Këshillit dhe organëve të parashikuar nga Ligji.

Neni 27

Ndihma ligjore

Administruesve dhe Këshilltarëve që u desh të përballonin procedura ndëshkimore për hir të Administratës dhe që u shfajësuan u përket shpërblimi i shpenzimeve gjyqi e ligjore.

TITULLI II

Organë burokratikë e zyra

Kreu I

Sekretari Bashkiak

Neni 28

Parime e kritere themelore gjestioni

Veprimtaria gjestionale e Entit, duke respektuar parimin e dallimit midis funksionit politik të drejtimit e kontrollit dhe funksionit të gjestionit administrues i besohet Sekretarit Bashkiak që e ushtron duke përfituar nga zyrat, sipas drejtimeve të Këshillit në zbatim të vendimeve të Juntës dhe të drejtimeve të Kryebashkiakut, nga i cili varet funksionalisht dhe duke ndjekur kriteret e caktuara në këtë Statut.

Sekretari Bashkiak, në përputhje me Ligjin që disiplinon statusin juridik, rolin e funksionet e tij, është organi burokratik që garanton drejtesën tekniko-administrative të zyrave dhe të shërbimeve.

Për zbatimin e objektivave të Entit ushtron veprimtarinë që i përket me pushtet nisme dhe autonomi zgjedhjeje të strumenteve operative dhe me përgjegjësi mbi rezultatet. Këto rezultate duhet t'i kontrollojë Kryebashkiaku, që i raporton Juntës.

Organit të njëjtë i besohen të drejta me karakter gjestional, këshillimor, mbikëqyrjeje e bashkërenditjeje, ligjshmërie e garancie, sipas normave të Ligjit dhe të këtij Statuti.

Neni 29

Të drejta gjestionale

Sekretarit Bashkiak i përket marrja e akteve gjestioni edhe me karakter të jashtëm që nuk bashkëbartin veprimtari vendimore dhe që nuk i jepen shprehimisht nga Statuti organëve të zgjedhur dhe të akteve që janë shprehje gjykimi teknik.

Veçanërisht Sekretari merr aktet pasuese:

- a) hartimin e programeve zbatimore, të referatave e shtesimeve me karakter organizativ, sipas drejtimeve të marra nga organët të zgjedhur;
- b) organizimin e personelit dhe të pasurive financiare e instrumentale të vëna në dispozicion të organëve të zgjedhur për zbatimin e objektivave e të programeve të caktuar nga këta organë;
- c) pagimin e shpenzimeve të urdhëruara sipas Rregullores;
- ç) marrjen e nënshkrimit të të gjitha akteve e vendimeve me karakter të jashtëm për të cilat ka kompetencë;
- d) kontrollin e të tërës fazës hetimore të vendimeve dhe nxjerrjen e akteve dhe masave, edhe të jashtëme, të ndërlidhura dhe të domosdoshme për zbatimin e vendimeve;
- dh) kontrollin e efektshmërisë dhe efektivitetit të zyrave dhe të personelit që i drejton;
- e) pagimin e shpërblësive dhe të shtesave të pagës për personelin, nëse janë të caktuara nga Ligji ose nga Rregullorja.

Neni 30

Të drejta këshillimore

1. Sekretari Bashkiak, nëse i kërkohet, merr pjesë në Komisionet e studimit e të punës mbrenda Entit e, me autorizimin e Juntës, në ato jashtë Entit.
2. Nëse i kërkohet, u shpreh mendime e vlerësime me karakter teknik e juridik Këshillit, Juntës, Kryebashkiakut, Asesorëve dhe çdo Këshilltari.
3. Nxjerr e nënshkruan mendimet e parashikuara nga Ligji mbi propozimet e masave vendimore.

Neni 31

Të drejta mbikëqyrjeje, drejtimi e bashkërenditjeje

1. Sekretari Bashkiak ushtron funksione shtyese, bashkërenditjeje, drejtimi e kontrolli ndaj zyrave dhe personelit.
2. Autorizon misionet, shërbimet e jashtëzakonshme, lejet e personelit, duke iu përmbahur normave në fuqi e Rregullores.
3. Merr masa për levizshmërinë e brendshme, duke iu përmbahur mënyrave të parashikuara në ujdite përkatëse.
4. Ushtron pushtetin e zëvendësimit në raste paefektshmërie të qartë. Ngre ngarkime fajeve, i propozon masa disiplinore Kryebashkiakut, i cili duhet t'i raportojë komisionit të disiplinës, nxjerr sanksionet e qortimit në shkrim dhe të qortimit të rëndë ndaj personelit, duke iu përmbahur normave të Rregullores.

Neni 32

Të drejta ligjshmërie dhe garancie

1. Sekretari merr pjesë në seancat e organëve kolegjalë të Komisioneve dhe të organizmave të tjera. Kujdeset edhe për hartimin e procesverbalit, me mundësi lëshimi brenda caqeve të parashikuara nga Ligji.
2. Merr nga Këshilltarët kërkesat e dorëzimit të vendimeve të Juntës që mund t'i nënshtrohen kontrollit të tyre.
3. Kryeson zyrën bashkiake për zgjedhjet në rastin e zgjedhjeve popullore dhe të referendumit.
4. Merr aktin e dorëheqjes së Kryebashkiakut, propozimet e shkarkimit nga detyra dhe mocionin e besimit ndërtimtar.
5. Kujdeset për dërgimin e akteve vendimore Komitetit Krahinor për Kontrollin dhe vërteton, pas njoftimit nga Lajmëtari Bashkiak përgjegjës, shpalljen në tabelën e lajmërimeve e ekzekutivitetin e vendimeve dhe të akteve të Entit.

Kreu II

Zyrat

Neni 33

Parime ndërtimore dhe organizative

1. Administrimi i Bashkisë zbatohet nëpërmjet një veprimtarie për objektive dhe duhet t'i përmbahet parimeve pasuese:

- a) organizim i punës jo për akte të shkëputura, po për shestime-objektive dhe për programe.
- b) analizë e pikasje e prodhueshmërisë dhe e ngarkimeve funksionale të punës e të shkallës së efektshmërisë të veprimitarisë të zhvilluar prej çdo elementi të aparatit.
- c) pikasje e përgjegjshmërive në lidhje të ngushtë me autonominë vendimore të subjekteve.
- ç) kapërcim i veçimit të ngurtë të kompetencave në ndarjen e punës dhe përkulshmëri sa më e madhe e ndërtimeve dhe e personelit.

2. Rregullorja pikas forma e mënyra organizimi e gjestioni të ndërtimit të brendhëm.

Neni 34

Hetim

Organizimi ndërtimor që synon ndjekjen e qëllimeve institucionale të Entit sipas normave të Rregullores ndahet në zyra që mund t'i përkasin edhe lëmenjve të ndryshëm, po janë të ndërlidhura funksionalisht për të arritur objektivet e caktuara.

Neni 35

Personeli

1. Bashkia nxit dhe zbaton përmirësimin e shërbimeve të personelit nëpërmjet modernizimin e ndërtimeve, formimin, cilësimin profesional dhe përgjegjësimin e nëpunësve.
2. Disiplina e personelit kufizohet në aktet normative të Entit që i japin zbatim Ligjeve dhe Statutit.
3. Rregullorja e statusit juridik e ekonomik të personelit disiplinon në veçanti:
 - a) ndërtimin organizativo-funksional;
 - b) pajisjen organike;
 - c) mënyrën e marrjes në punë dhe e reshtjes nga puna;
 - ç) të drejtat, detyrat e sanksionet;
 - d) mënyrën e organizimit të Komisioneve të disiplinës;
 - dh) shpërblimin ekonomik.
- 4) Si është parashikuar për organët administrativë, u përket pagimi i shpenzimeve të gjyqit dhe ligjore personelit që është nënshtruar një procedure ndëshkimore për hir të zyrës dhe pastaj u shfajësua.

TITULLI III

Shërbimet

Neni 36

Forma gjestioni

1. Veprimtaria që synon të ndjekë, në interesin e Bashkësisë, objektive e qëllime me rëndësi shoqërore, nxitjen e zhvillimit ekonomik e civil, duke përfshirë prodhimin e të mirave, zhvillohet nëpërmjet shërbimeve publike që mund gjestohen edhe me të drejtën e monopolit nga Bashkia, sipas Ligjit.
2. Zgjedhja e formës së gjestionit për çdo shërbim duhet bërë pasi u krahasuan dhe vlerësuan format e ndryshme të gjestionit të parashikuara nga Ligji dhe nga ky Statut.
3. Për shërbimet që duhen gjestuar në formë ndërmarrjeje krahasimi duhet bërë midis dhënies në koncesion dhe themelimit firmash, një ortakërie apo një shoqërie.
4. Për shërbimet e tjera krahasimi do të bëhet midis gjestionit me mjete të veta e dhënies në sipërmarrje ose në koncesion dhe midis formës të veçuar e formës shoqërore nëpërmjet konvente, bashkimi bashkish ose ortakërive.
5. Në organizimin e shërbimeve duhen në çdo rast garantuar forma të afta njoftimi, pjesëmarrjeje dhe mbrojtjeje për përdoruesit.
6. Këshilli Bashkiak i lëshon Bashkësisë Malore organizimin e gjestionin e funksioneve dhe të shërbimeve të veta kur përmasat e Bashkisë nuk lejojnë zbatimin e një gjestioni sa më të mirë dhe të efektshëm.
5. Organizimi dhe ushtrimi i shërbimeve me mjetet e veta disiplinohet prej Rregulloreve përkatëse.

Neni 37

Firma të veçanta

1. Këshilli Bashkiak, duke iu përmbahur normave të Ligjit dhe të Statutit, vendos aktet themelore të firmave të veçanta për gjestionin e shërbimeve prodhuese dhe të zhvillimit ekonomik e civil.
2. Rregullimi e funksionimi i firmave të veçanta disiplinohen nga Statuti përkatës dhe nga Rregullore të brendshme të veta të miratuara nga Këshilli i Administrimit të firmave.
3. Këshilli i Administrimit dhe Kryetari emërohen prej Këshillit Bashkiak midis personave jasht Këshillit që mund të zgjidhen si Këshilltarë Bashkiakë e kanë përvojë administrative të sprovuar.

Neni 38

Institucione

1. Këshilli Bashkiak, për ushtrimin e shërbimeve shoqërore të veçanta, themelon institucione nëpërmjet aktit përkatës që përmban Rregulloren e disiplinës të veprimtarisë dhe të organizimit, pasi u hartua një shtetim përkatës tekniko-financiar, nga i cili rezultojnë kostot, format e financimit dhe pajisija e të mirave.
2. Mund të parashikohet përfitimi nga personeli i marrë në punë me marrëdhënie të së drejtës private si edhe nga bashkëpunëtorë me një nivel të lartë profesionaliteti.
3. Drejtimit që duhen ndjekur miratohen nga Këshilli Bashkiak në çastin e themelimit dhe përditësohen me rastin e shqyrtimit të bilancit preventiv dhe të bilancit të mbylljes të institucioneve.
4. Organët institucionalë janë:
 - a) Këshilli i Administrimit, i emëruar nga Këshilli Bashkiak midis personave jashtë Këshillit vetë që mund të zgjidhen si Këshilltarë dhe kanë përvojë administrative të sprovuar, kujdeset për marrjen e të gjitha akteve të gjestionit me karakter të përgjithshëm të parashikuara nga Rregullorja, e cila disiplinon edhe numrin e përbërësve, kohën e qëndrimit në fuqi, gjendjen juridike e statusin si edhe mënyrat e funksionimit të organit.
 - b) Kryetari, i cili përfaqëson e kryeson Këshillin e Administrimit, mbikëqyr zbatimin e akteve dhe merr masa urgjente të cilat duhen ratifikuar nga Këshilli vetë.
 - c) Drejtori emërohet nga Këshilli Bashkiak, drejton veprimtarinë e tërë të institucionit dhe përgjigjet për personelin e për zbatimin e drejtimeve e të vendimeve të organëve të tjerë të institucionit.

Neni 39

Emërimi e shkarkimi nga detyra

1. Administruesit e firmave e të institucioneve emërohen nga Këshilli Bashkiak, brenda caqeve të Ligjit, në bazë të një dokumenti të pajisur me kurrikulat e kandidatëve, i cili tregon programin dhe objektivet që duhen arritur.
2. Dokumenti i propozuar, i nënshkruar nga së paku 1/5 e Këshilltarëve të caktuar, duhet t'i paraqitet Sekretarit Bashkiak së paku 5 ditë para mbledhjes.

3. Kryetari dhe çdo përbërës mund të shkarkohen nga detyra, pas propozimit të arsyetuar të Kryebashkiakut o të 1/5 të Këshilltarëve të caktuar, prej Këshillit Bashkiak i cili kujdeset për zëvendësimin e tyre.
4. Administruesve të sipërpërmendur u shtrihet detyrimi i nenit të mëparshëm 14, paragraf 4.

Neni 40

Gjestioni i përbashkët i shërbimeve dhe i funksioneve

Bashkia zhvillon marrëdhënie me Bashkitë e tjera dhe me Provincën për të nxitur dhe kërkuar format e shoqërisë më të përshtatshme ndër ato të parashikuara nga Ligji lidhur me veprimtaritë, shërbimet e funksionet që duhen zhvilluar dhe me objektivet që duhen arritur.

TITULLI IV

Kontrolli i brendshëm

Neni 41

Parime e kritere

1. Bilanci preventiv, bilanci i mbylljes dhe dokumentat e tjera të llogarisë duhet të lejojnë një lexim për programe e objektive, në mënyrë që, posh kontrollit financiar e të llogarive, të jetë i mundshëm edhe ai mbi gjestionin dha ai i lidhur me efektshmërinë e veprimit të Bashkisë.
2. Veprimtaria e revizionit mund të bashkëbartë propozime Këshillit Bashkiak në lëmin e gjestionit ekonomiko-financiar të Entit. Këshilli mund të u kërkojë organëve dhe të tjerave zyra kompetente mendime e propozime të veçanta për sa i përket aspekteve financiare e ekonomike të gjestionit e të çdo akti themelor, sidomos sa për organizimin e gjestionin e shërbimeve.
3. Normat e Rregullores dispijlojnë aspektet organizative e funksionale të zyrës së Revizorit të llogarive dhe i saktësojnë të drejtat e kontrollit, shtyses e garancisë, në përputhje me Ligjin e parimeve civile për sa i përket kontrollit të shoqërive dhe me këtë Statut.
4. Në Rregulloren vetë do të pikasen forma e procedura për një harmonizim operativ-funksional të drejtëpeshuar e korrekt midis sferës së veprimtarisë të revizorit dhe të asaj të organëve e të zyrave të Entit.

Neni 42

Revizori i llogarive

1. Revizori i llogarive, përveç cilesive të parashikuara nga normat mbi rregullimin e autonomive vendore, duhet të gëzojë zgjedhshmërinë sipas

Ligjit për zgjedhjen e Këshilltarëve Bashkiakë dhe duhet të mos bjerë në rastet e papajtueshmërisë të parashikuara.

2. Rregullorja mund të parashikojë arsye të mëtëjshme papajtueshmërie për të garantuar gjendjen e domosdoshme të paanësisë dhe të pavarësisë. Rregullorja do të disiplinojë edhe mënyrat e heqjes nga detyra e të rënies, në përputhje me normat që vlejné për revizorët e shoqërive aksionare.
3. Në ushtrimin e funksioneve të veta revizori do të ketë të drejtën, sipas menyrave të caktuara nga rregullorja, të shikojë aktet e dokumentet e lidhura me sferën e kompetencave të veta.

Neni 43

Kontrolli i gjestionit

1. Rregullorja do të pikasë metoda, tregues e parametra për vlerësimin e efektshmërisë, të efektivitetit dhe economicitetit të rezultateve të arritura në krahasim me programet e kostot e përballuara.
2. Teknika e kontrollit të gjestionit duhet të ndërtojë matës të aftë të vërtetojnë me afate periodike:
 - a) përputhjen e rezultateve në krahasim me parashikimet;
 - b) sasimin ekonomik të kostove të përballuara për vërtetimin e koherencës me programet e miratuara;
 - c) kontrollin e efektshmërisë dhe të efektivitetit të veprimtarisë administrative të zhvilluar;
 - ç) vërtetimin e ndryshimeve negative eventuale midis të programuarit dhe të zbatuarit dhe pikasjen e përgjegjësisë përkatëse.

PJESA II

RENDI FUNKSIONAL

TITULLI I

Organizimi territorial e format e bashkimit

Kreu I

Organizimi territorial

Neni 44

Bashkia

Bashkia e Strigarit është organizmi i decentralizimit, të cilit Ligji, Statuti dhe Rregullorja e posaçme i japin detyra gestioni të shërbimeve themelore e të drejtat e tjera të lëshuara.

Neni 45

Organizime mbibashkiake

Këshilli Bashkiak nxit e inkurajon forma bashkëpunimi me Ente publike të tjera, dhe kryesisht me Bashkësinë Malore, me qëllim të bashkërenditë dhe të organizojë me to shërbimet e veta, duke synuar të kapërcejë marrëdhëniet vetëm institucionale.

Kreu II

Format e bashkëpunimit

Neni 46

Parimi i kooperimit

Veprimtaria e entit, që synon të arrijë një o më objekte me interes të përbashkët me Ente vendore të tjera, organizohet duke përfituar nga normat e institutet të parashikuara nga Ligji nëpërmjet ujdivë e marrëveshjeve kooperimi.

Neni 47

Konventat

1. Bashkia nxit bashkëpunimin, bashkërenditjen dhe ushtrimin e bashkuar të funksioneve, edhe duke pikasur veprimtari të reja me interes të përbashkët, apo ekzekutimin e gjestionin e veprave publike, zbatimin e nismave e programeve të veçanta e të shërbimeve të tjera, duke privilegjuar lidhjen e konventave të posaçme me Ente të tjera vendore ose me Ente të tyre instrumentale.
2. Konventat, që përmbajnë elementet e detyrimet të parashikuara nga Ligji, miratohen nga Këshilli Bashkiak me shumicën absolute të përbërësve.

Neni 48

Ortakëritë

1. Këshilli Bashkiak, në përputhje me parimet e Statutit, nxit themelimin e ortakërisë midis enteve për të kryer e gjestuar shërbime të rëndësishme nën profilin ekonomik ose të ndërmarrjes apo për të kursyer nëse nuk është i leverdishëm themelimi i një firme të posaçme e nuk është i dobishëm përfitimi nga forma organizative për shërbimet vetë për të cilat është fjala në paragrafin e mëparshëm.

2. Konventa, posh përmbajtjes së parashikuar në paragrafin 2 të nenin të mëparshëm 47, duhet të parashikojë detyrimin e botimit të akteve themelore të ortakërisë në tabelat e lajmërimeve të Enteve ortakë.
3. Këshilli Bashkiak me konventën miraton edhe Statutin e ortakërisë, i cili duhet të disiplinojë rregullimin organizativ funksional të Entit të ri sipas normave të parashikuara për firmat e posaçme të bashkive, për sa janë të pajtueshme.
4. Ortakëria merr karakter shumëfunksional kur të njëjtat Entë vendore duan të gjestojnë një shumësi shërbimesh nëpërmjet sistemit të ortakërisë.

Neni 49

Bashkimi i Bashkive

Për të zbatuar parimin për të cilin është fjala në nenin të mëparshëm 46 e të parimeve të Ligjit për reformën e autonomive vendore, Këshilli Bashkiak, nëse paraqiten kushtet, themelon, në format e me qëllimet të parashikuara nga Ligji, Bashkime Bashkish me sunimin të përmirësues ndërtimet publike e t'i japë kolektivitetit shërbime më të efektshme.

Neni 50

Ujditë e programit

1. Bashkia, për kryerjen e veprave, ndërhyrjeve e programeve të parashikuara nga Ligji të posaçme o sektoriale që kërkojnë aktivizimin e një mase të ndërlikur për bashkërenditjen e integrimin e veprimtarisë që intereson edhe subjekte të tjera, nxit e përfundon ujdin programi.
2. Ujdia, posh qëllimeve të ndjekura, duhet të parashikojë:
 - a) përcaktimin e kohëve e të mënyrave të veprimtarive;
 - b) pikasjen e kostove, të burimeve të financimit e të rregullimit të marrëdhënieve midis Entete të ndërlikuara;
 - c) sigurimin e bashkërenditjes së çdo zbatimi, duke parashikuar edhe format për aktivizimin eventuale të arbitratit e të ndërhyrjeve zëvendësore;
 - ç) Kryebashkiaku përcakton e lidh ujdinë, duke iu përmbahur formaliteteve të tjera të Ligjit, pasi Këshilli Bashkiak shprehu me një vendim mendimin e tij.

TITULLI II

Pjesëmarrja popullore

Neni 51

Pjesëmarrja

1. Bashkia garanton e nxit pjesëmarrjen e qytetarëve në veprimtarinë e entit për të siguruar mbarëvajtjen, paanësinë e tejdukshmërinë.
2. Për këtë qëllim Bashkia privilegjon format e lira të bashkimit e organizimet e vullnetarisë, duke nxitur hyrjen e tyre në strukturat e shërbimet të Entit.
3. Qytetarëve u lejohen forma të drejtpërdrejta e të thjeshtësuara të mbrojtjes së interesave që inkurajojnë ndërhyrjen e tyre në forminin e akteve.
4. Administrata mund të aktivizojë forma zgjedhjeje për të njohur mendimin e subjekteve ekonomike mbi probleme të veçanta.

Kreu I

Nisma politike e administrative

Neni 52

Ndërhyrje në procedimin administrativ

1. Qytetarët e subjektet bartëse interesash të ndërlikuar në një procedim administrativ kanë mundësi të ndërhyjnë në të, posh rasteve shprehimisht të përjashtuara nga Ligji e nga Rregullorja Bashkiake.
2. Përfaqësimi i interesave që duhen mbrojtur mund kryhet me anën qoftë e subjekteve individuale qoftë të subjekteve kolektive përfaqësuese të interesave sipërindividuale.
3. Përgjegjësi i procedimit, në fillim të tij, detyrohet të njoftojë të interesuarit nëpërmjet lajmërimi personal që përmban të dhënat të parashikuara nga Ligji.
4. Rregullorja cakton cilat janë subjektet të cilave llojet e ndryshme të akteve duhen dërguar dhe nëpunësit përgjegjës të procedimeve përkatëse apo mekanizmat e pikasjes të përgjegjës të procedimit.
5. Ndëse paraqiten nevoja të veçanta ngutësie apo numri i marrësve ose papërcaktimi i këtyreve e bën veçanërisht të rëndë, mund të përjashtohet lajmërimi i drejtpërdrejtë me kusht që të dalë botimi në tabelën e lajmërimeve o me mjete të tjera, duke garantuar sidoqoftë forma të tjera publicizimi e njoftimi.
6. Ata që gëzojnë këtë të drejtë, brenda 30 ditësh nga lajmërimi personal ose nga botimi i masës, mund të paraqitin kërkesa, përkujtesa, propozime e dokumente që i përkasin objektit të procedimit.
7. Përgjegjesi i hetimit, brenda 20 ditësh nga marrja e kërkesave për të cilat është fjala në paragrafin të mëparshëm 6, duhet të vendosë mbi pranimin

ose mospranimin e të dërgojë përfundimet e tij organit bashkiak kompetent për nxjerrjen e vendimit përfundimtar.

8. Mospranimi apo pranimi i pjesëshëm i kërkesave apo lutjeve të marrura duhet të arsyetohet në mënyrë adekuate në parathënien e aktit e mund të prihet nga një diskutim me gojë.
9. Nëse ndërhyrjes pjesëmarrëse nuk i përket nxjerrja e një vendimi, administrata në çdo rast duhet të shprehë me shkrim, brenda 30 ditësh, vlerësimet e saj mbi kërkesën, petitionin e propozimin.
10. Subjektet për të cilat është fjala në paragrafin 1 kanë të drejtën të shqyrtojnë të gjitha aktet e procedimit, posh atyre që Rregullorja i ndalon.

Neni 53

Kërkesa

1. Qytetarët, shoqëritë, komitetet dhe subjektet kolektive në përgjithësi mund t'i drejtojnë Kryebashkiakut pyetje me të cilat i lypet llogari për aspekte të veçanta të veprimtarisë së Administratës.
2. Përgjigjja pyetjes i jepet brenda afatit maksimal të 30 ditëve nga Kryebashkiaku, Sekretari Bashkiak apo nga nëpunësi përgjegjës sipas natyrës politike apo gjestionale të aspektit në diskutim.
3. Mënyrat tregohen në Rregulloren mbi pjesëmarrjen, e cila duhet të parashikojë kohë e forma të pyetjes e të përgjigjes dhe masa adekuata për botimin e tyre.

Neni 54

Petitione

1. Të gjithë qytetarët mund t'u drejtohen, në formë kolektive, organëve të Administratës Bashkiake për t'i lypur ndërhyrjen në çështje me interes të përgjithshëm ose për të shtjelluar nevoja të përbashkëta.
2. Rregullorja për të cilën është fjala në paragrafin 3 të nenit 53 përcakton procedurën, kohët e format të botimit të petitionit, caktimin e organit kompetent i cili nis shqyrtimin dhe përgatit mënyrat e ndërhyrjes së Bashkisë mbi çështjen e ngritur apo vendos arkivimin nëse nuk mendon të pranojë përmbajtjen e petitionit, duke dhënë një arsyetim adekuat e të publicizuar.
3. Peticioni shqyrtohet nga organi kompetent brenda 30 ditësh nga paraqitja. Pasi kaloi ky afat çdo Këshilltar mund të ngrejë çështjen në Këshill, duke i lypur llogari Kryebashkiakut për vonesën apo duke hapur një diskutim mbi

përmbajtjen e peticionit. Kryebashkiaku detyrohet të vërë sidoqoftë peticionin në rendin e ditës të së parës seancë e Këshillit.

4. Procedimi përmbahet çdo herë me një vendim të shprehur, për të cilin subjektit propozues i garantohet lajmërimi.

Neni 55 *Propozime*

1. 50 qytetarë mund të paraqitin propozime për marrjen e akteve administrative që Kryebashkiaku i dërgon, brenda 30 ditësh të pastajme, organit kompetent, të pajisura me mendimet e përgjegjësve të shërbimeve të interesuara e të Sekretarit dhe me vërtetimin lidhur me mbulimin financiar.
2. Organi kompetent duhet të dëgjojë propozuesit e nismës brenda 30 ditësh qysh nga paraqitja e propozimit.
3. Midis Administratës Bashkiake dhe propozuesve mund të arrihet në lidhjen e ujdive në ndjekjen e interesit publik me qëllim të përcaktohet përmbajtja e masës përfundimtare për të cilën u nxit nisma popullore.

Kreu II *Bashkim e pjesëmarrje*

Neni 56 *Parime të përgjithshme*

1. Bashkia vlerëson format autonome bashkimi e kooperimi nëpërmjet formave nxitjeje të parashikuara nga neni i mëpashtëm 59 me afrueshmërinë e të dhënave që Administrata zotëron e nëpërmjet marrjes së formave të përshtatshme këshillimi në procedimin e formimit të akteve të përgjithshme.
2. Kriteret e përgjithshme përkatëse përcaktohen herë pas here nga Këshilli Bashkiak.

Neni 57 *Shoqatat*

1. Junta Bashkiake regjistrojnë, pasi e kërkuar të interesuarit e për qëllime për të cilat është fjala në nenin të mëparshëm, shoqatat që punojnë në territorin.
2. Vendimet administrative që kushtëzojnë apo mund të prodhojnë efekte mbi veprimtarinë e shoqatave duhet të paraprihen nga marrja e mendimeve të

shprehura nga organizmat kolegjalë të tyre brenda 30 ditësh nga kërkesa e subjekteve të interesuara.

Neni 58

Organizmat e pjesëmarrjes

1. Bashkia nxit e mbron format e ndryshme të pjesëmarrjes së qytetarëve. Të gjitha shoqatat kanë të drejtat e nismës të parashikuara në nenet e mëparshme.
2. Administrata Bashkiake për gjestionin e shërbimeve të veçanta mund të nxit themelimin e organizmave të posaçëm duke përcaktuar qëllimet që duhen ndjekur, kushtet për anëtarësinë, përbërjen e organëve të drejtimit, mënyrat e gjetjes së fondeve e gjestionin e tyre.
3. Organizmat për të cilët është fjala në këtë nen dëgjohen mbi lëmin e veprimtrarisë së tyre ose për ndërhyrje që kanë si objekt një pjesë të territorit. Mendimi përkatës duhet të njoftohet brenda 30 ditësh qysh nga kërkesa.

Neni 59

Nxitje

1. Shoqatave dhe organizmave pjesëmarrjeje mund t'u jepen forma nxitjeje me ndihma natyre qoftë financiare ose prone qoftë tekniko-profesionale e organizative.

Neni 60

Pjesëmarrja në komisionet

1. Komisionet e Këshillit, me kërkesën e shoqatave e organizmave të interesuar, ftojnë përfaqësuesit e tyre në punimet e veta.

Kreu III

Referendumi – E drejta e hyrjes

Neni 61

Referendumi

1. Parashikohen referendume këshillimore për të gjitha lëndët në kompetencën përjashtimore të Bashkisë, me qëllim të nxiten shprehje të vullnetit të cilat duhet të gjejnë një sintezë në veprimtarinë administrative.
2. Nuk mund të jenë objekt i referendumit taksat vendore apo tarifat, veprimtaritë administrative të caktuara nga Ligje shtetërore apo krahinore, lëndët për të cilat u mbajt një referendum në pesëvjetëshin e fundit.
3. Subjekte nxitëse të referendumit mund të jenë

- a) 1/10 e trupit zgjedhës;
- b) Këshilli Bashkiak.

4. Këshilli Bashkiak cakton në Rregulloren kushtet, pranueshmërine, kohët, mënyrat e pranimit e të organizimit të zgjedhjeve.

Neni 62

Efekte të referendumit

Brenda 60 ditësh nga shpallja e rezultatit nga Kryebashkiaku Këshilli vendos aktet e ndërlidhura e rrjedhimore të drejtimit, duke arsyetuar në mënyrë adekuate me vendim mospranimin eventual.

Neni 63

E drejta e hyrjes

1. Qytetarëve veç e veç apo të bashkuar u garantohet e drejta e hyrjes në aktet e administratës e të subjekteve që gjestojnë shërbime publike bashkiake sipas mënyrave të përcaktuara nga Rregullorja.
2. Përrjashtohen nga hyrja aktet që Ligji i shpall të rezervuara e që i nënshtrohen kufizimit të përhapjes e ato shprehimisht të pikasura nga Rregullorja.
3. Rregullorja disiplinon edhe rastet kur zbatohet instituti i hyrjes së shtyrë, duke përcaktuar normat për lëshimin e kopjeve.

Neni 64

E drejta e informimit

1. Të gjitha aktet e Administratës, të firmave e të institucioneve bashkiake janë publike, përveç rasteve të nenit 63.
2. Enti pikas, posh lajmërimit e botimit në tabelën, mjetet që mban si më të përshtatshme për përhapjen sa më të madhe të akteve.
3. Njoftimi duhet të jetë i përpiktë, në kohën e duhur, jo i dykuptimtë, i plotë e i tërë.
4. Junta merr masat organizative rrjedhimore.
5. Rregullorja disiplinon edhe botimin e akteve të parashikuara nga neni 26 i Ligjit 241/90.

Kreu IV

Mbrojtësi i qytetarëve

Neni 65

Emërimi

1. Mbrojtësi i qytetarëve emërohet nga Këshilli me votim të fshehtë dhe me shumicën e Këshilltarëve të caktuar në seancën fill pas asaj të zgjedhjes së Juntës, rri në fuqi për të njëjtën kohë e Këshillit që e zgjodh, duke ushtruar funksionet deri në hyrjen në fuqi të pasardhësit.
2. Mbrojtësi i qytetarëve, para hyrjes në fuqi, betohet në duart e Kryebashkiakut me këtë formulë: Betohem të ndjek besnikërisht Ligjet e Shtetit e të kryej funksionet e mia për qëllimin e së mirës publike.

Neni 66

Papajtueshmëri e rënie

1. Emërimi i Mbrojtësit të qytetarëve duhet të ndodhë midis personave që për përgatitjen e përvojën e tyre japin garanci të gjerë pavarësie, ndershmërie e kompetence juridike.
2. Nuk mund të emërohet në këtë zyrë
 - a) kush ndodhet në gjendje pazgjedhshmërie për detyrën e Këshilltarit Bashkiak;
 - b) deputetët, Këshilltarët krahinorë, provincialë, bashkiakë, anëtarët e Bashkësisë Malore e të USL;
 - c) ministrat e kultit;
 - ç) administruesit e nëpunësit e Enteve, instituteve, firmave e ndërmarrjeve që kanë marrëdhënie kontrate me Bashkinë ose që nga ajo, nën çdo titull, marrin subvencione e kontribute;
 - d) kush është në marrëdhënie juridike me Administratën Bashkiake në varësi nga veprimtari pune autonome ose të varur, profesionale apo tregtare;
 - dh) kush ka paraardhës apo pasardhës o farefisë o të afërm deri në shkallën e dytë që janë Administrues, sekretar apo nëpunës bashkiakë.
3. Mbrojtësi i qytetarëve bie nga detyra për arsye pazgjedhshmërie të mbiardhur. Rënia shpallet nga Këshilli me propozimin e një Këshilltari Bashkiak. Mund t'i hiqet detyra me vendim të Këshillit për moskryerjen e rëndë të detyrave të zyrës.
4. Detyra është nderi dhe kryhet falas.

Neni 67

Mjete e të drejta të posaçme

1. Zyra e Mbrojtësit të qytetarëve ka selinë në dhoma të përshtatshme të vëna në dispozicion nga Administrata Bashkiake e të pajisura me mjete për zyrën dhe me të gjitha të nevojshmet për funksionimin e mirë të zyrës vetë.
2. Mbrojtësi i qytetarëve mund të ndërhyjë, me kërkesën e qytetarëve veç e veç apo të bashkuar apo me nismën e vet ndaj Administratës Bashkiake, firmave të veçanta, institucioneve, koncesionarëve të shërbimeve, shoqërive që gjestojnë shërbime publike në caqet e territorit bashkiak për të vërtetuar se procedurat administrative ndjekin rrjedhën e rregullt e se aktet nxirren në mënyrë të përpiktë e në kohën e duhur.
3. Për këtë qëllim mund të thërresë përgjegjës të shërbimit të interesuar e të lyp dokumente, lajme, sqarime pa që mund t'i kundërqitet sekreti i zyrës.
4. Mund edhe të propozojë të shqyrtohen së bashku dokumentet brenda afatit të caktuar.
5. Pasi mori të gjitha njoftimet e dobishme, i dorëzon me gojë apo me shkrim mendimin e vet qytetarit që bëri kërkesën, në rast vonese u urdhëron organëve kompetentë të marrin masa brenda afatit të caktuar, u lajmëron organëve të sipërrenditur disfunkcionet, shpërdorimet e mungesat të pikasura.
6. Administrata detyrohet të japë arsyetime të posaçme nëse përmbajtja e aktit që nxirret nuk pranon sugjerimet e Mbrojtësit, i cili mund të lypë rishqyrtimin e vendimit, nëse vë re parregullsi apo të meta procedurale. Sidoqoftë Kryebashkiaku duhet të vërë çështjen në rendin e ditës të të parit Këshill Bashkiak.
7. Të gjithë përgjegjës të shërbimeve detyrohen të bashkëpunojnë sa më mirë me Mbrojtësin e qytetarëve.

Neni 68

Marrëdhënie me Këshillin Bashkiak.

1. Mbrojtësi i qytetarëve paraqit brenda muajit mars raportin mbi veprimtarinë e zhvilluar në vitin e mëparshëm, duke treguar disfunkcionet e pikasura dhe duke sugjeruar rrugëdalje për heqjen e tyre dhe duke formuluar propozime me synim përmirësimin e mbarëvajtjes e paanësinë e veprimtarisë administrative.
2. Raporti diskutohet nga Këshilli në sesionin pranveror dhe botohet.
3. Në raste rëndësie të veçantë ose që meritojnë një lajmërim të ngutshëm, Mbrojtësi mund në çdo cast t'i bëjë raport Këshillit.

TITULLI III

Funksioni normativ

Neni 69

Statuti

1. Statuti përmban normat themelore të rendit bashkiak. Atij duhet t'i përmbahem të gjitha aktet normative të Bashkisë.
2. Lejohet nisma së paku 80 qytetarëve për të propozuar ndryshime të Statutit edhe nëpërmjet një projekti të ndarë në nene. Në këtë rast zbatohet disiplina e parashikuar për pranimin e propozimeve të nismës popullore për të cilat është fjala në nenin të mëparshëm 55.
3. Statuti e ndryshimet e tij brenda 15 ditësh pas datës së hyrjes në fuqi u nënshtrohen formave botimi që lejojnë njohshmërinë e tyre reale.

Neni 70

Rregulloret

1. Bashkia nxjerr Rregullore për lëndët të lëshuara nga Ligji e Statuti dhe për ato që bien në kompetencën e saj, duke iu përmbahur Ligjeve shtetërore e krahinore, normave të përgjithshme të nxjerra, Statutit e vendimeve të tjera.
2. Nisma për Rregulloret i përket Juntës, çdo këshilltari dhe qytetarëve, sipas nenit të mëparshëm 55.
3. Rregulloret mund t'i nënshtohen një referendumi edhe me efekt heqës në caqet e sipas mënyrave të përcaktuara në nenin të mëparshëm 61.
4. Për formimin e Rregulloreve mund të këshillohen subjektet e interesuara.
5. Rregulloret i nënshtrohen një botimi të dyfishtë në tabelën e lajmërimeve sipas rregullave mbi botimin e vendimit vetë e për 15 ditë pasi vendimi i pranimi ka hyrë në fuqi. Rregulloret sidoqoftë i nënshtrohen një botimi që duhet t'i garantojë njohshmërinë reale. Ato duhet të mund lexohen nga qytetari që e do.

Neni 71

Përshtatja e burimeve normative bashkiake me Ligjet e mbiardhura

Përshtatjet e Statutit e të Rregulloreve duhet të kryhen, duke iu përmbahur parimeve të rendit bashkiak të përmbajtur në Kushtetutën, në Ligjin 142/90 dhe në Ligje të tjera e në Statutin, brenda 120 ditësh pasi dispozitat e reja kanë hyrë në fuqi.

Neni 72

Urdhëresat

1. Kryebashkiaku nxjerr urdhëresa me karakter të zakonshëm, duke zbatuar norma të Ligjit dhe të Rregulloreve.
2. Sekretari mund të nxjerrë në caqet e funksioneve të veta qarkullore e udhëzime që zbatojnë dispozitat e Ligjit.
3. Urdhëresat për të cilat është fjala në paragrafin 1 botohen për 15 ditë të njëpasnjëshme në tabelën e lajmërimeve dhe njëkohësisht aktivizohen të gjitha format e publicitetit për t'u dhënë përhapjen e njohjen sa më të madhe.
4. Kryebashkiaku nxjerr edhe urdhëresa të arsyetuara të përkohshme dhe të ngutshme për lëndët e qëllimet për të cilat është fjala në paragrafin 2 të nenit 38 delta të ligjit 142/90, të kufizuara në kohë sa zgjat gjendja e emergjencës.
5. Në rast mungese të Kryebashkiakut, urdhëresat i nxjerr ai që e zëvendëson sipas normave të Statutit.
6. Urdhëresat individuale duhet t'i drejtohen marrësit.

Neni 73

Norma të përkohshme e fundore

1. Ky Statut hyn në fuqi pasi u ndoqën normat e Ligjit. Nga ky cast resht zbatimi i normave të përkohshme.
2. Këshilli Bashkiak miraton brenda një viti Rregulloret e parashikuara nga Statuti. Deri në hyrjen në fuqi të këtyre Rregulloreve mbeten në fuqi normat e pranuar nga Bashkia sipas legjislacionit të mëparshëm që rezultojnë të pajtueshme me Ligjin e me Statutin.